



UNIVERSITETI "HAXHI ZEKA"
FAKULTETI AGROBIZNESIT

Të dhënat zyrtare për regjistrimin e studentëve për vitin akademi 2025/2026:

Regjistrimet në programet Bachelor:

Programi	Kuota e programit	Shënim
Teknologjia Ushqimore	50	Interesim më i lartë se kuota
Teknologjia e Prodhimit Bimor	40	Interesim më i lartë se kuota
Ekologjia e Aplikuar në Agrobiznes	40	Interesim më i lartë se kuota

Sipas raportit statistikor për regjistrim të semestrave, numri total i studentëve të regjistruar në vitin e parë (Bachelor 2025/2026): **114 studentë**

Regjistrimet në programet Master:

Programi	Numri i kandidatëve të regjistruar	Kuota totale (me vende të rezervuara)
Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit Ushqimor	16	25
Menaxhim Mjedisi	14	25

Politikat dhe kriteret e pranimit/regjistrimit:

Politikat e pranimit në programet e Fakultetit të Agrobiznesit janë të përcaktuara qartë dhe janë të disponueshme për publikun, në përputhje me Nenin 83 të Statutit të UHZ-së, Nenin 29 të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Rregullorevr të studime (Bachelor dhe Master).

- Konkursi publik për pranimin e studentëve të rinj shpallet në faqen zyrtare të UHZ-së, zakonisht gjatë muajve qershor-korrik (afati i parë) dhe gusht-shtator (konkursi plotësues nëse ka nevojë).
- Konkursi është i hapur për qytetarët e Kosovës, rajonit dhe studentët e huaj që përmbushin kriteret e përcaktuara.
- Programi i Teknologjisë Ushqimore zakonisht i plotëson kuotat e planifikuara që në afatin e parë.

Kriteret e pranimit në studimet Bachelor

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret bazë:

- Të posedojnë diplomë të shkollës së mesme;
- Të kenë kaluar me sukses Maturën Shtetërore;
- Të marrin pjesë në procedurën e vlerësimit, ku përdoret sistemi i pikëve:

Elementi i vlerësimit	Maksimumi i pikëve
Suksesi në shkollën e mesme	deri në 30 pikë
Rezultatet në Maturën Shtetërore	deri në 30 pikë
Testi (provimi) pranues	deri në 40 pikë

- Totali i pikëve: 100.
- Për t'u pranuar, kandidati duhet të arrijë së paku 40% të pikëve të parapara për provimin pranues.
- Përzgjedhja bëhet sipas ranglistës, duke respektuar parimin e mosdiskriminimit dhe barazisë.

Kriteret e pranimit në studimet Master:

- Kandidati duhet të posedojë diplomë të nivelit Bachelor në fushë relevante dhe të përmbushë kërkesat e përcaktuara në konkurs (nota mesatare, dokumente shoqëruese, etj.), në përputhje me rregulloret për studimet Master në UHZ.

Njohja e periudhave të studimit dhe transferimi:

- UHZ ka procedura të qarta për njohjen e periudhave të studimit (semestra, vite akademike, studime të kryera në institucione të tjera, praktika profesionale), të përcaktuara në Kalendarin Akademik dhe rregulloret përkatëse.
- Transferimi nga programe brenda UHZ-së apo nga universitete të tjera bëhet sipas Statutit të UHZ-së (nenet 138–140) dhe Rregullores për Studimet Bachelor, në afatet:
 - 1–15 shtator
 - 1–15 shkurt